




PLANI I INTEGRITETIT

**PËR DREJTORINË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
GJIROKASTËR 2026- 2029**

Miratuar me Urdhër nr.24, datë 30.01.2026
Të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

Z.Ardis Duka, Drejtor i DRTK Gjirokastrë / Drejtues i Grupit të Punës

Grupi i Punës, anëtarë:

- | | |
|---------------|---------------------------------|
| a) Vasil Polo | Përgjegjës i Sektorit të AAAMTK |
| b) Jani Duri | Përgjegjës Finance |
| c) Xheko Buci | Specialist |
| d) Eni Çuçi | Specialist |

Plani i Integritetit.

Plani i Integritetit për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) për periudhën 2026–2029 është një dokument strategjik që përcakton vizionin, objektivat dhe masat konkrete për forcimin e integritetit institucional dhe parandalimin e korrupsionit në administrimin e trashëgimisë kulturore. Ai është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe me udhëzimet e Ministrisë së Kulturës për qeverisjen e mirë në institucionet vartëse.

Integriteti institucional përkufizohet si aftësia e një institucioni për të vepruar në përputhje me ligjin, etikën dhe interesin publik, duke shmangur çdo formë të ndikimit të padrejtë apo abuzimit me pushtetin. Në fushën e trashëgimisë kulturore, integriteti merr rëndësi të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së lartë që kanë proceset e restaurimit, konservimit, dhënies së lejeve, menaxhimit të fondeve dhe bashkëpunimit me aktorë privatë e publikë.

Ky plan synon të krijojë një kulturë të qëndrueshme etike në institucion, të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të garantojë që çdo vendimmarrje të bazohet në parime të ndershmërisë, profesionalizmit dhe transparencës. Ai do të zbatohet në të gjitha strukturat e DRTK-së dhe do të përfshijë të gjithë punonjësit, pavarësisht nivelit hierarkik apo funksioni.

TABELA E PËRMBAJTJES

I - Procesi i hartimit të planit të integritetit.....

1.1.1- Ngritja e grupit të punës për hartimit e planit të integritetit

1.1.2- Identifikimi dhe Analiza e Riskut

1.1.3- Vlersimi I Riskut të Integritetit

1.1.4- Plani I Veprimit për Menaxhimin e Riskut

1.1- Qasja metodologjike.....

1.2- Përmbajtja e planit të integritetit.....

II - Risqet dhe Faktorët e Risqeve të Integritetit të Identifikuara dhe Faktorët e Risqeve.....

2.1- Risqe të lidhura me menaxhimin financiar dhe buxhetor

2.2- Risqe të lidhura me administrimin e burimeve njerëzore

2.3- Risqe në administrimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

2.4- Risqe në fushën e projekteve të restaurimit dhe ndërhyrjeve konservuese

2.5- Risqe në transparencë dhe marrëdhëniet me publikun

III- Plani i Veprimit.....

3.1- Monitorimi dhe raportimi i planit të veprimit

DEKLARATË E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë angazhohet të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me parimet e ligjshmërisë, integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke synuar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe lokale.

Institucioni njeh dhe vlerëson rëndësinë e parandalimit të korrupsionit, konfliktit të interesit dhe çdo forme tjetër të cenimit të integritetit institucional, duke zbatuar standarde të larta etike dhe profesionale në ushtrimin e funksioneve publike.

Në këtë kuadër, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë angazhohet:

- Të sigurojë zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- Të forcojë transparencën dhe llogaridhënien në proceset vendimmarrëse.
- Të promovojë etikën dhe integritetin profesional të stafit.
- Të parandalojë dhe menaxhojë risqet që lidhen me korrupsionin dhe konfliktin e interesit.
- Të bashkëpunojë me institucionet përkatëse dhe komunitetin lokal për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Kjo Deklaratë përbën bazën e angazhimit institucional për zbatimin e Planit të Integritetit dhe për forcimin e besimit të publikut në veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë është hartuar gjatë periudhës 2026. Ky plan është përgatitur duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet publike, si dhe në dokumentet udhëzuese për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit në administratën publike.

Qëllimi i Planit të Integritetit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë është:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit që mund të komprometojnë aftësinë e institucionit për të ushtruar funksionet e tij publike në mënyrë të paanshme, profesionale dhe të përgjegjshme, si dhe identifikimi i faktorëve që mund të mbështesin ose rrisin këto risqe;
- Formulimi i masave të përshtatshme për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e risqeve të identifikuara.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe i faktorëve përkatës është kryer për proceset e punës sipas fushave kryesore të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë. Këto fusha përfshijnë, ndër të tjera:

- a) fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetor.
- b) fushën e administrimit të burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve.
- c) fushën e kontrollit dhe inspektimit të trashëgimisë kulturore.
- d) fushën e transparencës dhe marrëdhënieve me publikun.
- e) fushën e administrimit, mbrojtjes dhe monitorimit të pasurive kulturore.
- f) fushën e projekteve të restaurimit dhe ndërhyrjeve në monumente kulture.
- g) fushën e bashkëpunimit me institucionet qendrore, vendore dhe subjektet e treta.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë u zhvillua përmes zbatimit të fazave të mëposhtme:

1.1.1 Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit

Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë ngriti grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e Planit të Integritetit të institucionit, në përputhje me aktet në fuqi. Në përbërje të grupit të punës u përfshinë punonjës të institucionit nga nivele të ndryshme drejtuese dhe teknike, si dhe specialistë të fushës së trashëgimisë kulturore, administratës dhe financës. Grupi i punës u kryesua nga një koordinator, i cili siguroi mbarëvajtjen e procesit, koordinimin e aktiviteteve dhe bashkëpunimin ndërmjet strukturave të ndryshme të institucionit. Në funksion të lehtësimit të procesit të vlerësimit të riskut dhe hartimit të Planit të Integritetit, grupi i punës u asistua nga një sekretariat teknik.

1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë, si dhe rregulloreve dhe procedurave të brendshme institucionale. Analiza u mbështet në vlerësimin e praktikave ekzistuese të punës, raportet e brendshme të monitorimit dhe informacionin e përftuar nga strukturat përbërëse të institucionit. U evidentua se, megjithëse janë ndërmarrë hapa pozitivë në drejtim të forcimit të integritetit institucional, mbeten ende sfida që lidhen me standardizimin e procedurave, transparencën, monitorimin dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore.

Në këtë fazë u realizua gjithashtu konsultimi me stafin e institucionit, përmes diskutimeve dhe mbledhjes së të dhënave cilësore, me qëllim identifikimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve që ndikojnë në to.

1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit

Në këtë fazë, grupi i punës vlerësoi intensitetin e risqeve të identifikuara dhe analizoi faktorët që mund të kontribuojnë në shfaqjen ose përshkallëzimin e tyre. Risqet u renditën sipas nivelit të përparësisë, duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre potencial në veprimtarinë e institucionit dhe në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, u vlerësua efektiviteti i masave ekzistuese të kontrollit dhe u identifikua nevoja për masa të reja ose përmirësimin e masave ekzistuese, me synim menaxhimin më efikas të risqeve të integritetit.

1.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut

Në përfundim të procesit të vlerësimit, grupi i punës hartoi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë. Ky plan

përfshin masa konkrete për parandalimin, zvogëlimin ose eliminimin e risqeve të identifikuar, afatet kohore për zbatimin e tyre, si dhe përgjegjësitë organizative përkatëse. Zbatimi i këtij Plani Integriteti parashikohet për periudhën 2026-2029. Kostot financiare për zbatimin e planit do të mbulohen nga buxheti i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë, si dhe, sipas rastit, në bashkëpunim me projekte dhe programe mbështetëse të asistencës teknike

1.2 Qasja metodologjike.

Në procesin e vlerësimit të risqeve të integritetit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë është ndjekur një qasje e kombinuar metodologjike, duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore, me qëllim sigurimin e një analize sa më të plotë dhe gjithëpërfshirëse të problematikave që lidhen me integritetin institucional. Metoda cilësore është përdorur përmes analizës së dokumentacionit ekzistues institucional, përfshirë raportet e brendshme të monitorimit, dokumentet strategjike, aktet rregullatore dhe procedurat e brendshme që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Në mënyrë të veçantë, kjo metodë shërbeu për identifikimin e proceseve të punës që paraqesin ekspozim më të lartë ndaj risqeve të integritetit, sjelljeve joetike apo parregullsive administrative.

Analiza cilësore përfshiu gjithashtu shqyrtimin e raporteve të auditimit, dokumenteve të menaxhimit financiar, si dhe informacioneve të përfituara nga bashkëpunimi institucional me struktura të tjera përgjegjëse për transparencën, kontrollin dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe vlerësimit të kuadrit të brendshëm rregullator të DRTK-së, për të identifikuar nevojën për përmirësim ose standardizim të mëtijshëm të procedurave të punës.

Metoda sasiore u aplikua përmes realizimit të një ankete të strukturuar me punonjësit e institucionit, me qëllim vlerësimin e perceptimeve të tyre mbi çështje që lidhen me integritetin, etikën profesionale dhe transparencën në ushtrimin e detyrave funksionale. Pyetësorët u plotësuan në mënyrë anonime, duke garantuar konfidencialitetin e përgjigjeve dhe besueshmërinë e rezultateve. Të dhënat e përfituara nga anketimi shërbyen si element mbështetës për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit në institucion.

Kombinimi i këtyre dy metodave mundësoi një vlerësim më të balancuar dhe objektiv të situatës së integritetit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

1.3 Përmbajtja e Planit të Integritetit

- Plani i Integritetit i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë përbëhet nga këto pjesë kryesore:
- Deklarata e Integritetit Institucional, e cila pasqyron angazhimin dhe vullnetin e drejtuesit të institucionit për promovimin e integritetit, etikës dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve publike;
- Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit, që përfshin përshkrimin e fazave të procesit të planifikimit, metodologjinë e ndjekur dhe përfshirjen e strukturave të institucionit;
- Identifikimi dhe analiza e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, ku trajtohen risqet kryesore që lidhen me fushat e veprimtarisë së institucionit, në veçanti administrimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, menaxhimin financiar, burimet njerëzore, transparencën dhe marrëdhëniet me publikun;
- Plani i Veprimit, i cili përmban masat konkrete të kontrollit dhe ndërhyrjet e nevojshme për adresimin e risqeve të identifikuara, afatet kohore për zbatimin e tyre dhe përgjegjësitë organizative përkatëse.

Plani i Integritetit, së bashku me Planin e Veprimit, synon të shërbejë si një dokument funksional dhe dinamik, që orienton veprimtarinë e përditshme të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë drejt interesit publik, standardeve të larta profesionale dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës institucionale.

II-RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet një analizë e zgjeruar e risqeve të integritetit dhe faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e tyre, të identifikuara në përputhje me fushat kryesore të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë. Analiza është fokusuar në proceset e punës që lidhen drejtpërdrejt me administrimin, mbrojtjen, restaurimin dhe monitorimin e trashëgimisë kulturore, si dhe në funksionet mbështetëse administrative dhe financiare.

Risqet e identifikuara lidhen me cenimin e parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë, dhe mund të ndikojnë negativisht në ruajtjen e vlerave kulturore, në cilësinë e shërbimeve publike dhe në besimin e publikut ndaj institucionit.

2.1. Risqe të lidhura me menaxhimin financiar dhe buxhetor

Këto risqe lidhen me planifikimin, administrimin dhe përdorimin e fondeve publike, veçanërisht në rastet e financimit të projekteve të restaurimit dhe ndërhyrjeve në pasuritë kulturore. Faktorë të riskut përfshijnë mungesën e kontrollit të brendshëm efektiv, procedura të paqarta financiare dhe kapacitete të kufizuara për monitorimin e shpenzimeve.

2.2 Risqe të lidhura me administrimin e burimeve njerëzore

Në këtë kategori përfshihen risqe që lidhen me rekrutimin, vlerësimin dhe menaxhimin e stafit, mungesën e trajnimeve specifike në fushën e trashëgimisë kulturore dhe etikës profesionale, si dhe ekspozimin ndaj ndikimeve të jashtme në ushtrimin e detyrave funksionale.

2.3. Risqe në administrimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

Këto risqe lidhen me ndërhyrje të paautorizuara ose të papërshtatshme në monumente kulture, mungesën e monitorimit të vazhdueshëm në terren, dëmtime nga faktorë natyrorë apo njerëzorë dhe moszbatim të standardeve profesionale të ruajtjes dhe restaurimit.

2.4. Risqe në fushën e projekteve të restaurimit dhe ndërhyrjeve konservuese

Këto risqe lidhen me përzgjedhjen e projekteve, mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Faktorë risku janë mungesa e ekspertizës së specializuar, mbikëqyrja e pamjaftueshme teknike dhe presionet për realizimin e projekteve jashtë standardeve të miratuara.

2.5. Riske në transparencë dhe marrëdhëniet me publikun

Bazuar në ligjin **nr.119/2014** për **Të Drejtën e Informimit** i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion pasi mungesa e informimit të plotë dhe të rregullt të publikut mbi vendimmarrjen institucionale, projektet në zbatim dhe aktivitetet e ndërmarra mund të krijojë perceptim negativ dhe të ulët në besimin e komunitetit lokal dhe aktorëve të interesit.

III- PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave parandaluese dhe korrektuese që synojnë adresimin e risqeve dhe faktorëve të risqeve të integritetit të identifikuar në veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë. Ky plan përbën një instrument plotësues të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi dhe shërben për forcimin e integritetit institucional, transparencës dhe përgjegjshmërisë në administrimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Plani i Veprimit është hartuar mbi bazën e analizës së proceseve të punës dhe funksioneve institucionale të DRTK-së dhe ka për qëllim përmirësimin e kontrollit të brendshëm, parandalimin e praktikave të papërshtatshme dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në mënyrë të veçantë, Plani i Veprimit synon arritjen e objektivave kryesore për forcimin e integritetit institucional, si më poshtë:

- Forcimi i kuadrit rregullator dhe procedural të integritetit, si dhe i instrumenteve për parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe abuzimeve në administrimin e pasurive kulturore;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike të stafit, si dhe zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme në fushën e trashëgimisë kulturore, etikës dhe integritetit;
- Rritja e transparencës institucionale dhe përmirësimi i komunikimit me publikun, përfshirë komunitetin lokal dhe grupet e interesit, me qëllim rritjen e besimit publik dhe nxitjen e partneritetit në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

3.1-MONITORIMI DHE RAPORTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

- Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit do të kryhet në mënyrë periodike, përmes **raporteve 6-mujore dhe vjetore**, dhe do të fokusohet në vlerësimin e progresit të realizimit të masave të parashikuara, në përputhje me afatet dhe përgjegjësitë e përcaktuara.
- Procesi i monitorimit do të vlerësojë efektivitetin e masave të zbatuara, ndikimin e tyre në përmirësimin e integritetit institucional, si dhe identifikimin e ndryshimeve të mundshme në kontekstin e veprimtarisë së institucionit ose në nivelin e risqeve të integritetit. Në rast se konstatohet nevoja për ndërhyrje shtesë, masat ekzistuese dhe prioritetet e Planit të Veprimit mund të rishikohen dhe përshtaten.
- Raportimi për zbatimin e Planit të Veprimit është një proces i rregullt dhe i strukturuar, i cili siguron ndjekjen e vazhdueshme të masave dhe përmbushjen e objektivave të Planit të Integritetit. Ky proces do të koordinohet nga Koordinatori i Integritetit pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë, i cili do të jetë përgjegjës për mbledhjen e informacionit, përgatitjen e raporteve të monitorimit dhe ndjekjen e progresit të zbatimit.
- Raportet e monitorimit, pas miratimit nga drejtuesi i institucionit, do të shërbejnë si bazë për marrjen e masave përmirësuese në rast të vonesave ose vështirësive në zbatimin e masave të planifikuara, si dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Nr	Fusha e Veprimtaris / Riskut	Ngjarjet e mundshme të rrezikut	Masat për adresimin e rrezikut	Struktura Përgjegjëse	Afati i Zbatimit	Treguesi i realizimit
I	MONITRIMI I TERRITORIT DHE MONUMENTEVE					
1.1	Ndërtime pa leje në Zonën UNESCO (Gjirokastrë)	Specialistët të terrenit lejojnë shtesa apo ndryshim fasadash kundrejt ryshfetit.	1.Verifikimi i befasishëm i raporteve nga Grupi i Monitorimit	Specialistët e Terrenit	2026	Regjistër digjital ose Raporte
1.2	Ndërhyrje të paligjshme në Tepelenë & Përmet	Kryerja e punimeve nga persona pa prezencën e specialistëve ose lejen përkatëse.	1.Krijimi i një rrjeti komunikimi me specialistët e sektorëve dhe kryepelqët e fshatrave 2.Inspektime të papritura për çdo monument.	Përgjegjësit e sektorëve Tepelenë / Përmet	Çdo muaj	Nr. i process verbaleve të inspektimit.
1.3	Mos raportimi i dëmtimeve	Specialistët nuk raportojnë degradimin	Përditësimi i Kartelave – Gjëndja e objektit	Sektori Teknik	Çdo 6 muaj	Kartela e Monumentit
II	ARKEOLOGJIA DHE SITET ARKEOLOGJIKE					
2.1	Gërmimet nga personat e paautorizuar.	Personat në terren i neglizhojnë ose e kanë të pamundur mbulimin e zonave të largëta ose me vështirësi terreni.	1.Kontakte me persona që mund të jenë afër zonave 2.Përdorimi dronëve për monitorimin e tyre.	Specialistët e Arkeologjise	2026-2029	Raportimi
2.2	Trafikimi i mundshëm i gjetjeve rastësore	Fshehja e artefakteve të gjetura gjatë punimeve.	Raporti Arkeologjik	Sektori Arkeologjik	Gjatë projekteve arkeologjike	Krijimi i një ditari gërmimesh

III	LEJET E RESTAURIMIT DHE PROJEKTET						
3.1	Mos evidentimi në kohë I ndërtimit në Zonën Muzeale dhe të mbrojtur	Neglizhenca ose dakortësia për përfitim personal.	Ndryshimi I grupit të monitorimit në raport me zonat përkatëse	Përgjegjesi I Sektorit/ Drejtori	Gjatë vitit	Raportet mujore,6-mujore dhe vjecare	
IV	MENAXHIMI FINANCIAR DHE BILETARIA						
4.1	Problematikat në Biletarinë e Kalasë së Gjirokastrës dhe Parku Arkeologjik I Antigones	Mos prerja e biletave për grupet turistike ose probelmatika të ngjashme	Grup monitorimi të papritura	Biletaria	Gjatë Punës	Raportim	
VI	BURIMET NJERËZORE DHE ETIKA						
6.1	Konflikte dhe interesa	Punët private	Nënshkrimi I deklaratës vjetore të integritetit.	Jurist/ Burimet Njerëzore	Çdo fillim viti	Deklarata të firmosura	

GRUPI I PUNËS

Ardis Duka  Kryetar

Vasil Polo 

Jani Duri 

Xheko Buci 

Eni Çuçi 